



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:020247

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05767698

C.nr. 74/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses E, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë përfaqësuesit të autorizuar F.H dhe F.SH, kundër të paditurit G (I) G nga fshati Lladroc, Komuna e Malishevës, me bazë juridike riburësim i dëmit, vlera objektit të kontestit 2,278.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, më datën 21.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses E, me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri G (I) G nga fshati Lladroc, Komuna e Malishevës, që paditëses E, me seli në Prishtinë, që në emër të ribursimit të dëmit material dhe jo material nga aksidenti i trafikut i shkaktuar më datë 30.12.2020, në Malishevë, t'ia, kompensoj shumën prej 2,249.33 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 31.01.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses E përtej shumës prej 2,249.33 euro e deri në shumën 2,278.00 euro, dhe atë në shumën prej 28.67 euro.

IV. DETYROHET i padituri, në emër të shpenzimeve procedurale paditëses, të t'ia paguajë shumën prej 180.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja E, me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesve të saj të autorizuar më datën 31.01.2022, në këtë gjykatë ndaj të paditurit G (I) G nga fshati Lladroc, Komuna e Malishevës, ka parashtruar padinë për riburësim të dëmit, në shumën prej 2,278.00 euro.

Kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore më datën 27.09.2023 dhe seancën e shqyrtimit kryesor me datën 21.05.2024, ku ka prezantuar i autorizuari paditëses, ndërsa nuk ka prezantuar i paditurit, ku sipas fletë kthesave është konstatuar se ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt,

ndërsa mungesat tij nuk e ka arsyetuar. Gjykata seancën e shqyrtimit përgatitor dhe seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur në mungesë të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt, konform nenit 423.4 të LPK-së.

Të autorizuarit të paditëses F.H dhe F.SH, në padi, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare kanë deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Duke shtuar se paditësja në cilësinë e të siguruarit ka kontraktuar policën nga auto përgjegjësia me të siguruarin I.G për periudhën kohore nga data 15.09.2020 deri me datën 15.09.2021, për automjetin e markës “G”, me targa ..... Nga kjo bazë e sigurimit dhe nga ky rast i siguruar për dëmin e shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 30.12.2020, në Malishevë, paditësja e ka paguar shpërblimin e dëmit të dëmtuarve A.S dhe E.S, në shumën prej 2,278.00 euro. Po ashtu ka theksuar se nga raporti i aksidentit rezulton se i padituri në momentin e aksidentit ka qenë pa patentë shofer. Për të vërtetuar lartësinë e dëmeve materiale dhe jo materiale gjykatës i kanë propozuar nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i makinerisë, si dhe për ekspert kanë propozuar B.L nga Prishtina. Pas pranimit të ekspertizës mbi vlerësimin e dëmit, kanë theksuar se ndaj të njëjtës nuk kanë vërejtje dhe nuk kërkojmë sqarime shtesë nga eksperti. Andaj pas administrimit të provave gjykatës i kanë propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 21.05.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: Raportin e aksidentit, me nr. 2020-ER-623, i datës 30.12.2020; kërkesën për regresim të dëmeve të paguara, me nr. 219/2021 dhe 309/2021, e datës 08.11.2021, e E konfirmimin e sigurimit, me nr. të policës 7578609, prej datës 15.09.2020 deri me datë 15.09.2021; 17 fotografi bardhë dhe zi, të paraqitura në 2 faqe A4; listën e dëmeve për pagesën, e kryer nga E, me datë 04.11.2021; marrëveshjen jashtëgjyqësore për lëndët: 219/21 dhe 309/21-TPL, e datës 14.10.2021, e lidhur në mes E , me A.S dhe E.S dhe ekspertizën mbi vlerësimin e dëmit në mjetin motorik, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 08.11.2023, nga eksperti B.L

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Me administrimin e raportit të aksidentit, me nr. 2020-ER-623, i datës 30.12.2020, (të cilit ia dha besimin e plotë), gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri me datën 30.12.2020, rreth orës 17:35 min, në Malishevë, duke e drejtuar automjetin e tipit “G”, me targa ....., pa patentë shofer shkaktonte aksident trafikun nga i cili dëme material pëson automjeti i tipit “S”, me pronar A.S, si dhe dëm jo material pëson E.S.

Me administrimin e konfirmimit të sigurimit, me nr. të policës 7578609, të datës 01.02.2021 (të cilit ia dha besimin e plotë), gjykata ka vërtetuar faktin se automjeti i markës “G”, me targa ....., me të cilin është shkaktuar aksidenti në momentin e ndodhjes së aksidentit ka qenë i siguruar tek

e paditësja E, me mbulesë të sigurimit nga data 15.09.2020 deri me datën 15.09.2021, ndërsa sigurimi ishte në emër të I.G nga fshati Lladroc, Komuna e Malishevës.

Me administrimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore për lëndët: 219/21 dhe 309/21-TPL, e datës 14.10.2021, e lidhur në mes paditëses E, dhe të dëmtuarve A.S dhe E.S (të cilës ua dha besimin e plotë), gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja dhe të dëmtuarit, kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 30.12.2020, sipas së cilës marrëveshje palët janë pajtuar që i dëmtuari A.S të kompensohet në shumën prej 700.00 euro për dëmin e pësuar në automjetin e tij të tipit “S”, me targa ..., ndërsa e dëmtuara E.S të kompensohet në shumën prej 1,200.00 euro për të gjitha format e dëmit të paraparë sipas LMD-së, si pasojë e lëndimeve të shkaktuar në këtë aksident.

Me administrimin e listës të dëmeve për pagesën, e kryer nga E, me datë 04.11.2021 (të cilës ia dha besimin e plotë), gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 14.10.2021, e ka kryer pagesën ndaj dëmtuarit A.S, në shumën prej 700.00 euro, ndaj të dëmtuarës E.S shumën prej 1,200.00 euro, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 378.00 euro, apo gjithsej në shumë të përgjithshme prej 2,837.00 euro,

Me administrimin e ekspertizës lidhur me vlerësimin e lartësisë së dëmit të shkaktuar në automjet, të ekspertit makinerisë B.L, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 08.11.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se ekspertiza në bazë të fotografive të automjetit të dëmtuar, çmimit të pjesëve të automjetit, çmimit për riparim e pjesëve të dëmtuar dhe normativi i kohës së punës, ka konstatuar se riparimi i dëmit në automjetin e markës “S”, i shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 31.12.2020, ka qenë teknikisht i mundur dhe ekonomikisht i arsyeshëm, ndërsa vlera e riparimit të dëmit ka qenë në shumën prej 671.33 euro. Gjykata ekspertizën vlerëson të hartuar dhe argumentuar mirë dhe në mënyrë profesionale, pasi që i njëjti mendim është dhënë duke u bazuar në shkresat e lëndës, andaj të njëjtën e pranoj të besueshëm dhe të njëjtës ia fali besimin në plotësi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi për faktin se sipas nenit 136 par.1 të LMD-së parashihet që *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa sipas nenit 14 par.1 nën par. 1. 4 dhe par. 3 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/L-018 përcaktohet se *“I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur drejtuesi nuk ka leje të vlefshme dhe adekuate për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimëve të drejtimit të mjetit nga kandidati, sipas të gjitha rregullave të përcaktuara për procesin e mësimit;”*, dhe par. 3 *“Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese”*, ndërsa neni 12 par. 1 e përcakton se *“Fondet e sigurimeve shëndetësore, personale dhe invalidore kanë të drejtë, lidhur me detyrimet e përmbushura ndaj siguruësve të tyre, të parashitrojnë kërkesa regresi nga baza e sigurimit të auto përgjegjësisë për rimbursimin e dëmit real, brenda kufijve të përgjegjësisë të siguararit me kontratë, pasi që ato janë paguar”*.

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të lartpërmendura, të cilave ua fali besimin e plotë, e duke analizuar edhe thëniet e palës paditëse në procedurë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovet si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Krejt kjo bazuar në faktin se gjykata e ka vërtetuar faktin se me datën 30.12.2020 në Malishevë, i padituri duke e drejtuar automjetin e markës “G”, me targa ....., pa patentë shofer ka shkaktuar aksident trafiku, duke e goditur veturën e markës “S”, me targa .... me pronar A.S, me ç ‘rast veturës “S”, i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 671.33 euro, ndërsa të dëmtuarës E.S, i është shkaktuar dëm jo material, në shumën prej 700.00 euro. Po ashtu është vërtetuar e automjeti i cili ka shkaktuar aksidentin e trafikut ka qenë i siguaruar te E, e cila edhe iu ka kompensuar të dëmtuarve dëmin e shkaktuar, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 378.00 euro, shuma e tërësishme e cila iu është paguar të dëmtuarve është në lartësi prej 2,278.00 euro, andaj në këtë rast paditësja ka fituar të drejtën ligjore që të kërkoj regres nga i padituri.

Sa i përket lartësisë së dëmit të shkaktuar gjykata vendosi për kompensimin e paditëses si në diapozitivin II të këtij aktgjykimi pasi që sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në bazë ekspertizës të ekspertit makinerisë B.L, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 08.11.2023, është vërtetuar dëmi i shkaktuar automjetin e tipit “S”, në shumën prej 671.33 euro, si dhe në sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore të datës 14.10.2021 dhe listës të dëmeve për pagesën, e kryer nga E, me datë 04.11.2021, është vërtetuar dëmi jo material të shkaktuar të dëmtuarës E.S, në shumën prej 1,200.00 euro.

Gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja e ka kompensuar të dëmtuarin A.S në emër të dëmit të shkaktuar në automjetin e tij tipit “S”, në aksidentin e datës 30.12.2020, në vlerën prej 700,00 €uro, e cila shumë i është paguar, mirëpo sipas ekspertizës të ekspertit B.L është konstatuar se dëmi i shkaktuar në automjetin e tipit “S”, është në shumën prej 671.33 euro, andaj gjykata ka vendosur si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar pjesën e kërkesëpadiës shumën prej 28.67 euro.

Prandaj, gjykata gjatë procedurës bëri vlerësimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, kurse në arsyetimin e aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar në marrjen e vendimit si më lartë, duke u bazuar në nenin 143 par. 1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore”*, për çka ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136 par. 1, nenit 174 si dhe nenit 382 të LMD-së, por edhe të nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që i padituri t’ia kompensojë paditëses shumën si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që i referohen,

taksës gjyqësore në shumë prej 30.00 euro, dhe për ekspertizën shumë prej 150.00 euro, në shumë e përgjithshme prej 180.00euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr. 74/2022, më datë 21.05.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.